Aktualitet

Shkeli orën policore, polici qëllon për vdekje në kokë e shpatull të riun në Tiranë! Arrestohet efektivi

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur rreth orës 01:45 të mëngjesit në rrugën "Dritan Hoxha" në Tiranë, ku 25 vjeçari Klodjan Rasha është qëlluar për vdekje nga një polic, në lagjen e tij, pak metra larg shtëpisë. I riu nuk i është bindur urdhrit të policit për të ndaluar, dhe pasi është ndjekur që nga rruga "Don Bosko" ku është konstatuar për shkak se ai ka thyer orën policore, sipas polici i ka drejtuar armën efektivit, çka ka bërë që ky i fundit të reagojë duke e qëlluar.

Ligji, polici, arma
Efektivët pa kamera trupi, të servisit pranë vendit të ngjarjes kanë qenë të fikura
I riu kishte probleme psikologjike! Në 2016 ka plagosur një person me kaçavidë
Policia: I riu ka pasur armë! Në vendngjarje u sekuestrua pistoleta dhe krehëri me fishekë
Fqinja: S'ka sjellë asnjëherë shqetësime! Ishte i papunë

Redaksia
8 Dhjetor, 06:57 | Përditesimi i fundit: 9 Dhjetor, 14:53

Tiranë-Një ngjarje e rëndë ka ndodhur rreth orës 01:45 të mëngjesit në rrugën "Dritan Hoxha" në Tiranë, ku 25 vjeçari Klodjan Rasha është qëlluar për vdekje nga një polic, në lagjen e tij, pak metra larg shtëpisë. I riu nuk i është bindur urdhrit të policit për të ndaluar, dhe pasi është ndjekur që nga rruga "Don Bosko" ku është konstatuar në shkelje të orës policore, sipas polici i ka drejtuar armën efektivit, çka ka bërë që ky i fundit të reagojë duke e qëlluar.

Rasha, është qëlluar nga polici me 2 plumba, një në shpatull dhe një në kokë. Njëri nga plumbat i ka ardhur pas shpine. Si pasojë e plagëve që ka marrë i riu ka ndërruar jetë në spital. Për këtë ngjarje efektivi është arrestuar dhe në dëshminë e tij, ka thënë se ka dashur ta ndalojë të riun pasi ka thyer

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

MINUTË PAS MINUTE
22:43 Nis marshimi paqësoj i disa qytetarëve nga Kryeministria te banesa e Klodjan Rashës
22:39 U dhunua nga protestuesit, efektivi 36 vjeç! Ka çarje me xham në sy, rrezikon ta humbasë
22:37 Valteri me tone të ashpra në Repolitix: Nëse polici shpallet fajtor për vrasjen e 25 vjeçarit, Lleshaj, Veliu e Jaupaj të japin dorëheqjen!
22:25 Shkatërrimet dhe dëmtimet gjatë protestës, Bashkia e Tiranës në punë për rikthimin e tij si më parë (FOTO)
22:03 Pas mbylljes së protestës për vrasjen e Klodjan Rashës, bilndohen dyert e kryeministrisë

MOTI Shqiperi

orën policiore e jo ta vrasë, por 25 vjeçari e ka kërcënuar dhe është larguar me vrap. Ai është nisur ta qëllojë në pjesën e poshtme të trupit, por kur ka gjuajtur herën e dytë nga errësira nuk e ka parë se ku e kapur plumbi.

LEXO EDHE:

Shkatërrimet dhe dëmtimet gjatë protestës, Bashkia e Tiranës në punë për rikthimin e tij si më parë (FOTO)

Pas kqyrjes së vendit të ngjarjes dhe zonës përreth policia ka gjetur armën e zjarrit pistoletë që mbante i riu me një krehër me fishekë. Sipas burimeve arma i ka rënë Rashës gjatë ndjekjes, rreth 100 metër larg vendit ku është vrarë. Gazetari i Report Tv, Sokol Dema raporton se zona është e pajisur me kamera sigurie, madje i riu është vrarë pranë kamerave të një servisi makinash. Por sipas informacioneve të fundit kamerat e servisit kanë qenë të fikura dhe nuk kanë kapur asgjë. Edhe efektivi nuk ka pasur kamera trupi të instaluara. Po ashtu bëhet me dije se janë vetëm disa pamje të një biznesi në afërsi të Kupolës, që kanë kapur disa sekuenca të lëvizjes në vrapim e sipër, me shpejtësi të të riut.

Sipas fqinjëve dhe familjarëve i riu kishte psaur probleme më parë por jo tani. ***Xhaxhai*** i 25 vjeçarit Hasan Rasha, ka deklaruar se Klodjani kishte dalë për të pirë një kafe. Sipas tij ai nuk ka pasur armë me vete në momentin që është vrarë, ndryshe nga versioni i policisë. Më tej ai shton se familjarët fillimisht janë lajmëruar se ka ndodhur aksident, më pas se është arrestuar, por në fund u thanë se 25 vjeçari ishte vrarë. Sipas Xhaxhait 25 vjeçari pasi është kuruar me ilaçe për nerva dhe është shtruar, nuk ka shfaqur më probleme.

Njoftimi i policisë së Shtetit

Me datë 08.12.2020, rreth orës 01:45, sherbimet e Policisë gjatë patrullimit në rrugën "Dritan Hoxha", kanë konstatuar një shtetas i cili kryente veprime të dyshimta. Punonjësit e Policisë i kanë bërë thirrje të ndalonte por personi nuk i është bindur urdhërit të Policisë për të ndaluar. Edhe pas thirrjeve të vazhdueshme të bëra nga ana e Punonjësit të Policisë për të ndaluar përsëri nuk ka ndaluar dhe është larguar me vrap duke i drejtuar punonjësit të policisë një send të fortë në dukje armë zjarri.

I gjendur në këto kushte dhe në mungesë të ndriçimit të plotë punonjësi i policisë ka qëlluar me armë zjarri dhe për pasojë ka mbetur i plagosur shtetasi K.R., 25 vjeç i cili ka humbur jeten në spital.Menjeherë është ngritur Grupi i Posaçëm Hetimor i përbërë nga SHÇBA dhe Policia. Prokurori ndodhet në vendngjarje dhe po ndjek e monitoron të gjitha veprimet që po kryhen nga Sherbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në MB dhe nga Policia për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes.Punonjësi i policisë shtetasi N.H., është shoqëruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për veprime të metejshme. Vijon puna intensive nga grupi hetimor për zbardhjen e dinamikës së ngjarjes.

Viktima Klodjan Rasha

Tiranë, i drejtoi armën dhe nuk iu bind, polici qëllon për vdekje në kokë e shpatull të riun

Qytetet	Mërkurë	Enjte	Premte
Tirana	11.9°C	12.52°C	9.98°C
Korce	6.99°C	7.45°C	4.56°C
Shkoder	11.27°C	13.16°C	10.63°C
Gjirokaster	14.92°C	10.97°C	8.75°C

Me te lexuarat e dites | Me te lexuarat e javes

Lajme | Fotogaleri | Videogaleri

1. U shtir si motra e Klodjan Rashës, por nuk ishte! Vajza mashtroi mediat gjatë protestës, viktima kishte vetëm dy vëllezër
2. U vra dje nga efektivi në Tiranë, familjarët përcjellin për në banesën e fundit mes dhimbjesh Klodjan Rashën
3. Dëshmia/ I penduari Luftar Reçi: Lul Berisha më kërkoi të vras Klodjan Saliun, në këmbim të hiqte hasmin tim! Porositi bombë me telekomandë për ekzekutimin e Vajdin Lamajt, e mori Shullazi
4. Mashtroi mediat se ishte motra e Klodjan Rashës, protestuesja: Sivjet prisnim ta martonim, jo ta përcillnim për në varreza! Policia gjuan me armë në ajër, jo në kokë (VIDEO)
5. Mbi 4 orë protestë te Ministria e Brendshme e Kryeministria! U vihet flaka pemëve të Krishtlindjeve, protestuesit sulmuan institucionet dhe shkatërruan zbukurimet, gjuajnë me gurë policinë
6. U vra nga efektivi/ Përcillet mes dhimbjesh në banesën e fundit Klodjan Rasha! Lleshaj: Të zbardhet sa më parë e vërteta! Policia e Shtetit: Jemi të gjithë të prekur, po analizojmë ngjarjen
7. Vrasja e 25 vjeçarit Klodian Rasha nga polici, reagon ministri Lleshaj: E vërteta, ngushëllimi më i madh! Të zbardhet sa më parë ngjarja
8. Publikohet fotoja/ Kush është Luftar Reçi i dënuari me 25 vite që i hapi probleme lordëve të krimit! Për t'i shpëtuar burgut, tha se ka qenë te e dashura bullgare
9. I bie të fikët protestueses, u shtir si motra e Klodjan Rashës! Qytetarët i japin ndihmën e parë
10. Ekspertiza paraprake/ Klodjan Rasha nuk ka marrë asnjë plumb në kokë! Pritet përgjigja e armës nëse është prekur nga 25-vjeçari



Viktima Klodjan Rasha

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:34

Qëlloi për vdekje 25 vjeçarin në Tiranë, ndalohet polici

Ndalohet polici që vrau me armë Klodjan Rashën në orët e para të mëngjesit në Tiranë.

Efektivi i skuadres "Shqiponja" e qëlloi 25 vjeçarin për vdekje me 2 plumba. Ai akuzohet për "Vrasje në kushtet e kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme".

Efektivi i policisë ka tre javë që ishte bërë pjese e sektorit "Shqiponja". Më parë ai ka shërbyer si polic patrulle në disa komisariate në Tiranë.

Ora 12:58

U vra nga polici në Tiranë, 25 vjeçari është djali i një ish-efektivi

Klodjan Rasha i riu që është qëlluar për vdekje me 2 plumba nga një polic, është djali i një ish-oficeri

Këtë e ka konfimruar xhaxhai i tij Hasan Rasha, në një prononcim për media.

> *"Klodi është një djalë ish-oficeri. Kam dëgjuar që thonë se ka pasur armë. Kjo është në mënyrë apsolute e pavërtetë. Ai ka qenë i sëmurë dhe është kuru me ilaçe për nerva dhe herë të tjera ka qenë edhe i shtruar për këtë punë. Gjatë ditës ka punuar me babain vet. Ma vonë është ndjerë i lodhur është shtrirë në krevat dhe ka dalë më pas me pi një kafe. Kur ka njoftu policia të vëllain se djali është arrestu nga policia", ka thënë ai.*

Ora 12:30

25 vjeçari në Tiranë u qëllua pas shpine! Efektivi: S'doja ta vrisja, por ta qëlloja në pjesën e poshtme të trupit! E paralajmërova 'ndal policia'

Detaje të reja janë zbardhur nga vrasja e Klodjan Rashës nga efektivi i policisë në orët e para të mëngjesit të sotëm në Tiranë.

Gazetari i Report Tv Arsen Rusta ka thënë se polici e ka qëlluar pas shpine të riun.

Duke iu referuar dëshmisë së policit, gazetari thotë se ai nuk ka dashur që ta vrasë, por ka dashur që ta qëllojë në pjesën e poshtme të trupit. Por kur e ka qëlluar herën e dytë nga errësira nuk e ka parë se ku e kapur plumbi.

> *"Kam dashur që ta qëlloj në pjeset e poshtme të trupit. Qëllova njëherë dhe pastaj qëllova për të dytën herë dhe nga errësira nuk e kuptova se ku qëllova. Sdoja ta vrisja e kam paralajmëruar disa herë që të ndalet", është kjo një pjesë tejtër e dëshmisë së zbardhur.*

Ora 11:17

Vrau 25 vjeçarin me 2 plumba, zbardhet dëshmia e policit: Më kërcënoi dhe iku me vrap! E ndoqa nga pas

Zbardhet deklarata e efektivit të policisë që ka vrarë me 2 plumba 25 vjeçarin Klodjan Rasha në orët e para të mëngjesit të sotëm në Tiranë.

Në dëshminë e tij efektivi ka thënë se ka dashur ta ndalojë të riun pasi ka thyer orën policiore duke dalë pas orës 22:00, por 25 vjeçari e ka kërcënuar dhe është larguar me vrap. Ndërsa polici e ka ndjekur nga pas.

Ora 10:53

Vrasja e 25-vjeçarit në Tiranë/ Kur polici mund të përdorë armën e zjarrit, çfarë parashikon ligji (VIDEO)

Cfarë parashikon ligji për përdorimin e armës nga policët? Neni 135 për Policinë e Shtetit saktësohen pikat kur polici mund të përdor armën e zjarrit.

Neni 135

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit dhe subjektet e tjera mund ta përdorin armën e zjarrit të shërbimit, në ushtrim të detyrave të tyre dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji, vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm si mjet i fundit për të parandaluar ose neutralizuar veprimet e dhunshme të rrezikshme të personit me rrezikshmëri të lartë për jetën dhe shëndetin e tij dhe personave të tretë, kur mjetet e tjera të përdorimit të forcës nuk kanë dhënë rezultat ose nuk arrijnë objektivat e ligjshëm të detyrave funksionale.

2. Shmangia e një rreziku nëpërmjet përdorimit të armëve të zjarrit nga subjektet që u njihet kjo e drejtë, bëhet për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tyre ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit, që kërcënon atë ose një person tjetër apo pasurinë e tyre nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbrapsur.

Neni 58

Përgjegjësia e punonjësit të policisë Punonjësi i policisë që mban armë zjarri, përgjigjet për marrjen e masave që kanë të bëjnë me shmangien e:

a) dëmtimeve të armës, humbjes dhe përdorimit të saj nga persona të tjerë;

b) modifikimit të armës dhe të municioneve;

c) qitjeve aksidentale;

ç) demonstrimeve të panevojshme dhe kërcënuese.

Neni 59

Rregullat për mbajtjen dhe përdorimin e armës

1. Mbajtja e armës në situatat e punës, bën të detyrueshëm zbatimin e rregullave të mëposhtme:

a) pistoleta të mbahet në brez, në anën e djathtë ose të majtë sipas lehtësisë së përdorimit, e futur në këllëf, e siguruar që të mos dalë në mënyrë të pavullnetshme, pa fishekë në folenë e fishekut dhe në siguresë;

b) arma e gjatë e zjarrit dhe speciale mbahet gjithmonë në krah, sipas mënyrës së rekomanduar në instruktazh/manualin përkatës, pa fishekë në folenë e fishekut, në siguresë.

2. Në situatat e punës, kur punonjësi i policisë nuk është i veshur me uniformën e policisë, ai detyrohet të tregojë kujdes maksimal për shmangien e ekspozimit të armës individuale.

3. Punonjësit të policisë i ndalohet hyrja me armë zjarri në objekte kulti, në mjedise paraburgimi, në zyra e përfaqësi diplomatike, në zyrat e administratës së lartë shtetërore.

4. Përgjegjësitë për zbatimin e rregullave të mbajtjes dhe përdorimit të armëve të zjarrit klasifikohen:

a) përgjegjësi individuale, e cila nënkupton përgjegjësinë administrative individuale, në rastet kur punonjësi i policisë ka përdorur armën në kundërshtim me rregullat;

b) përgjegjësi e urdhërdhënësit, e cila nënkupton përgjegjësinë administrative të urdhërdhënësit, në rastet kur keqpërdoren apo kapërcehen kompetencat prej tij.

Ora 10:32

Vrasja e të riut në Tiranë nga polici/ Efektivët pa kamera trupi, të servisit pranë vendit të ngjarjes kanë qenë të fikura

Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se janë sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë në zonën përreth ngjarjes, përfshirë edhe në servisin që gjendet pak metra larg vendit ku është ekzekutuar 25-

vjeçari, Klodjan Rasha.

Kamerat e servisit kanë qenë të fikura dhe nuk kanë kapur asgjë. Po ashtu bëhet me dije se janë vetëm disa pamje të një biznesi në afërsi të Kupolës, e cila ka kapur disa sekuenca të lëvizjes në vrapim e sipër me shpejtësi të të riut.

Ndërkohë, efektivi i policisë që ka shtënë në drejtim të Rashës kishte dy javë që ishte transferuar në repartin "Shqiponja". Edhe efektivët "Shqiponja" nuk kanë patur kamera trupi të instaluara, thonë po ashtu burimet. Më parë ka shërbyer në Komisariatin nr. 5 në Kamëz.

Ora 10:07

U vra me 2 plumba nga polici, i riu kishte probleme psikologjike! Në 2016 ka plagosur një person me kaçavidë

Klodjan Rasha i riu që është vrarë me 2 plumba nga polici në Tiranë, sipas fqinjëve dhe familjarëve kishte probleme psikologjike.

Në vitin 2016 kur është arrestuar për plagosje të lehtë me dashje, 25 vjeçari ka plagosur një person me kaçavidë, ndërsa burimet raportojnë se ka patur probleme depresioni që më herët.

Edhe familjarët, edhe banorë të zonës flasin për probleme psikologjike.

Ora 09:56

Pamje nga vendngjarja/ Gjak në tokë, 25 vjeçari në Tiranë u vra para kamerave të një servisi

Këto janë pamjet nga vendi i ngjarjes ku u vra me 2 plumba 25 vjeçari Klodjan Rasha afër shtëpisë së tij në Tiranë.

Në servisin ku është vrarë i riu ka kamera sigurie të cilat mund të kenë filmuar gjithçka nëse kanë qenë funksionale.

Ora 09:56

Vrasja e të riut në Tiranë/ Ka pasur armë me vete, i ka rënë gjatë ndjekjes rreth 100 metër larg vendit të ngjarjes

Detaje të reja janë zbardhur nga vrasja me 2 plumba e 25 vjeçarit Klodjan Rasha në Tiranë.

Burime shumë të besueshme më thonë se 25-vjeçari ka pasur me vete armë, armë e cila i ka rënë gjatë ndjekjes, rreth 100 metër larg vendit ku është vrarë.

Ora 09:39

Vrasja e të riut në Tiranë nga polici/ Xhaxhai: Është djalë ish-oficeri! Doli për të pirë kafe, s'kishte armë me vete! Ka qenë i sëmurë dhe është kuruar për nerva

Hasan Rasha, xhaxhai i Klodjan Rashës të riut i cili është ***qëlluar për vdekje*** me 2 plumba, një në shpatull dhe një në kokë, nga një efektiv në Tiranë, në lagjen ku banonte, ka deklaruar se nipi i tij kishte dalë për të pirë një kafe.

Sipas tij, i riu nuk ka pasur armë zjarri me vete në momentin që është vrarë, ndryshe nga versioni i policisë të cilët thanë se kanë sekuestruar armën e të 25 vjeçarit të cilët ia ka drejtuar policit. Më tej Hasan Rasha shton se familjarët fillimisht janë lajmëruar se ka ndodhur aksident, më pas u është thënë se është arrestuar, por në fund u thanë se 25 vjeçari ishte vrarë. Ndër të tjera në deklaratën e tij ai shton se 25 vjeçari është djali i një ish-oficeri dhe se më parë ka qenë i sëmurë, por sipas tij pasi është kuruar me ilaçe për nerva dhe është shtruar, nuk ka shfaqur më probleme.

> *Klodi është një djalë ish-oficeri. Kam dëgjuar që thonë se ka pasur armë. Kjo është në mënyrë apsolute e pavërtetë. Ai ka qenë i sëmurë dhe është kuru me ilaçe për nerva dhe herë të tjera ka qenë edhe i shtruar për këtë punë. Gjatë ditës ka punuar me babain vet. Ma vonë është ndjerë i lodhur është shtrirë në krevat dhe ka dalë më pas me pi një kafe. Kur ka njoftu policia të vëllain se djali është arrestu nga policia. Më vonë i kanë thënë se djali ka bë aksident me policinë më vonë i kanë thënë se ka vdek. Më gjatë nuk di unë. Kam pasur dy kokrra hurma dhe ka dalë me pi një kafe, tani na kanë thënë se ai është o vdekur.*
>
> *Mua më ka njoftu vëllai dhe kam ardhur këtu. Djali ka dalë me pi një kafe dhe ka pasur 2 kokrra hurma me vete. Ka dalë për të pirë një kafe, ka qenë i sëmurë përpara, por gjatë ditës ka qenë duke punu. Çfarë armësh more zotëri. Babai i vet ka qenë duke flet, ai ka shkuar se më kanë kapur djalin policia. As nuk dimë vetëm dimë se është në morg.*
> *Edhe në emër të vëllait jemi të gjithë të nderuar që vini këtu për të na e zbardhur këtë punë dhe kërkojmë që kjo të zbardhet dei në funhd. djali nuk ka pasur apsolutisht që gje me vete. Besimin e kemi edhe nga ju edhe nga shteti. Këtu punë ta zbardhin deri në fund", tha ai.*

I riu është qëlluar për vdekje pak metra larg shtëpisë. Ai nuk i është bindur urdhrit të policit për të ndaluar, dhe pasi është ndjekur që nga rruga "Don Bosko" ku është konstatuar duke lëvizur në shkelje të orës policore, i ka drejtuar armën efektivit, çka ka bërë që ky i fundit të reagojë duke e qëlluar.

Pasi u qëllua me 2 plumba, një në shpatull dhe një në kokë, 25 vjeçari ka ndërruar jetë në spital. Edhe vetë polici i cili pas ngjarjes është shoqëruar në komisariat në dëshminë e tij ka thënë se ka dashur ta ndalojë të riun pasi ka thyer orën policiore e jo ta vrasë, por 25 vjeçari e ka kërcënuar dhe është larguar me vrap. Kur e ka qëlluar nga errësira nuk e ka parë se ku e ka kapur plumbi pasi thekson se ka dashur ta kapë në pjesën e poshtme të trupit.

Ndonëse xhaxhai thotë se 25 vjeçari nuk kishte armë me vete, policia pas kqyrjes së vendit të ngjarjes dhe zonës përreth ka njoftuar se ka gjetur armën e zjarrit që mbante i riu. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit pistoletë me një krehër me fishekë.

Sipas burimeve se 25-vjeçarit arma i ka rënë gjatë ndjekjes, rreth 100 metër larg vendit ku është vrarë. Zona është e pajisur me kamera sigurie, madje i riu është vrarë pranë kamerave të një servisi makinash. Por kamerat e servisit kanë qenë të fikura dhe nuk kanë kapur asgjë, sakaq edhe efektivët "Shqiponja" nuk kanë pasur kamera trupi të instaluara. Sipas fqinjëve i riu kishte probleme psikologjike. Ndërkaq 25 vjeçari rezulton të jetë një person me precedentë të mëparshëm penalë.

Ora 09:18

Vrasja e të riut afër shtëpisë nga polici/ Zona e pajisur me kamera sigurie

Gazetari i Report Tv, Sokol Dema raporton se zona është e pajisur me kamera sigurie, çka mund të sjellin edhe zbardhjen e plotë të ngjarjes ku efektivi qëlloi me dy plumba një në kokë dhe një në shpatull të riun Klodjan Rasha.

Ora 09:07

U vra nga polici me 2 plumba në Tiranë, i riu u ndoq për shkak të orës policore

I riu Klodjan Rasha i cili është vrarë me 2 plumba nga një polic në orët e para të mëngjesit të sotëm në Tiranë, është ndjekur që nga rruga "Don Bosko" ku është konstatuar, për shkak se kishte thyer orën policore që fillon në orën 22:00 sipas një urdhri të Komitetit Teknik.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:45 të mëngjesit.

Ora 08:55

Vrasja në Tiranë, i riu u qëllua nga polici me një plumb në shpatull dhe një në kokë

Dalin detaje të reja nga vrasja e 25 vjeçarit Klodjan Rasha në Tiranë në orët e para të mëngjesit të sotëm në lagjen "Dritan Hoxha" në Tiranë.

Mësohet se i riu është qëlluar me një plumb në shpatull dhe një në kokë.

Ora 08:44

Vrasja e të riut në Tiranë nga polici, fqinja: S'ka sjellë asnjëherë shqetësime! Ishte i papunë

Fqinja e 25 vjeçarit Klodjan Rasha i cili u qëllua për vdekje në orët e para të mëngjesit të sotëm në lagjen "Dritan Hoxha" në Tiranë ka thënë për media se i riu nuk njihej si problematik në zonë.

Për të ajo ka thënë se nuk ka sjellë asnjëherë shqetësime dhe se ishte i papunë.

> *"Jo asgjë unë tani po e dëgjoj. Ka qenë shumë i mirë si njeri. Nuk ne di me ça është marrë ne e shikonim këtu jashtë dhe ka qenë djalë shumë i mirë. Ishte pa punë. Unë po bëj gati 25 vjet këtu. Djalë shumë i mirë për mua. E shikoja gjithmonë këtu jashtë që rrinte dhe nuk ngacmonte njeri. Nuk di gjë për arrestimet e yij më parë.Nga ai djalë skemi pasur shqetësime asnjëherë. Këtu rrija unë përballë e ke", tha ajo.*

Ora 08:40

U vra nga polici, 25 vjeçari u qëllua pak metra larg shtëpisë së tij në Tiranë (Pamjet)

Kjo është lagjja e 25 vjeçarit Klodjan Rasha ku dhe u qëllua për vdekje nga polici gjatë orëve të para të mëngjesit në Tiranë.

I riu është qëlluar në lagjen e tij, në fillim të rrugicës ku ai banonte.

Ora 08:06

Del fotoja e të riut që u qëllua për vdekje nga polici në Tiranë

Ky është i riu Klodjan Rasha i cili është qëlluar për vdekje nga një polic në orët e para të mëngjesit në Tiranë.

Ora 07:58

U qëllua për vdekje nga efektivi në Tiranë, policia: I riu ka patur armë! Në vendngjarje u sekuestrua pistoleta dhe krehër me fishekë

Dalin detaje të reja nga vrasja e 25 vjeçarit Klodjan Rasha, në orët e para të mëngjesit në Tiranë.

Policia konfirmon se 25 vjeçari ka patur me vete armë, e cila është gjetur pasi Rasha është qëlluar.

"Në vijim të veprimeve hetimore të kryera nga Grupi i Posaçëm Hetimor i përbërë nga SHÇBA dhe Policia nën drejtimin e Prokurorit gjatë kqyrjes së vendit të ngjarjes dhe zonës përreth u bë e mundur gjetja e armës së zjarrit që dyshohet se i përkiste shtetasit K.R, i cili nuk iu bind urdhërit të Punonjësit të Policisë për të ndaluar.

U sekuestrua në cilësinë e provës materiale armë e zjarrit pistoletë me një krehër me fishekë. Vijon puna intensive nga grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorit për zbardhjen e plotë të dinamikës së ngjarjes.

Ora 07:41

U vra në Laprakë nga polici, 25 vjeçari më parë ishte dënuar për plagosje dhe pengmarrje

Klodjan Rasha 25 vjeçari, i ekzekutuar në orët e para të mëngjesit të sotëm në rrugën "Dritan Hoxha" në Tiranë, rezulton të jetë një person me precedentë penalë.

I riu më parë është dënuar për plagosje të lehtë me dashje dhe për heqje të paligjshme të lirisë në vitin 2016.

Ora 07:30

U qëllua për vdekje nga polici në mesnatë në Tiranë, zbulohet emri i 25 vjeçarit

Klodjan Rasha është emri i 25 vjeçarit që është qëlluar për vdekje në orët e para të mëngjesit të sotëm në rrugën "Dritan Hoxha".

I riu është qëlluar pasi nuk i është bindur urdhrit të policit për të ndaluar, kësisoj ai ka ndërruar jetë në spital.

r.k./Be.K./Shqiptarja.com

TAG: tirane | policia e shtetit | laprake | vrasje ne tirane | vrasja e klodjan rashes | Hasan Rasha

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

A mendoni se efektivi i policisë mund ta shmangte vrasjen e 25-vjeçarit?

PO | JO | NUK E DI

Komento

Komente

Free: 09/12/2020 13:22

Njerzia nuk eshte GJOBE me dy kembe dhe Policia te jete ne sherbim te popullit dhe jo grup cunash dhe zhdukin prova.

Përgjigju

Prind i kujdesshem: 09/12/2020 09:58

Babai eshte ne gjume ne 2 nates,,dhe nuk e di se ku e ka djalin,,,si e ze gjumi kete prind nuk e kuptoj....mua nuk do me zinte gjumi....

Përgjigju

Nona krimit: 09/12/2020 09:46

FAMILJES te ketij hajvanit qe dilte per te pire kafe ne 2 te nates me arme ne brez ti hiqet e drejta e votimit per 10 vjet.....

Përgjigju

Edmond: 09/12/2020 07:54

Per mu kot i thon polic se nuk meret jeta tjetrit polici duhet te shkrehi armen kur ti pergjigjet me arm viktima pastaj duhet te qelloj ta provon njiher te vllai vet tja vrasin si do ti vij policia e shteti ton ka marre kot nuk edi se si ju duket vetja sdin as te komunikojn me qytetarin direkt me ofendime din nuk edi aka shtet tju boj te gjithve psikologun se per polica qe kena ne te gjith neper kafe i gjen ne orar te punes ka dhe polica qe nuk krahasone me keto qe sdin me fol jan shum komunikus sdi cfare tju them tjeter gjynaf ja nderprevi jeten ne mes tani shteti do mbroj shten cfare sdo nxjerin jo arm etj

Përgjigju

Free: 08/12/2020 23:23

Arma u gjet 100m larg ath ku e pa armen efektivi qe u ndje i kercenuar? Ai e ka goditur nga shum afer qe ne erresire e xuri ne koke po gjithsesi u mat per ne kembe. Plus ato kamerat gjithmon fikur kur duhet dhe ndezur kot per pune tjera. Sju vje turp polici shkerdhate.

Përgjigju

Iris: 08/12/2020 23:13

Nje tragjedi shqiptare e trishte per te dy palet.Nje djalosh me precedente kriminale dhe me probleme mendore.Si ka mundesi qe ky person mbante Akoma arme?! Une nuk I di rregullat aty,por ketu ku jetoj,personat me histori kriminale e psikologjike,nuk lejohen te mbajne arme.Familja vete, duhet te mos ia lejonte armen.Dicka tjeter qe nuk shkon ne kete histori,jane fjalet e xhaxhait qe ka dale te pije kafe ne 1:45 te mengjesit.Kush pi kafe ne ate ore ?!Vetem njerezit qe punojne turni I trete e pine atehere se u duhet te rine zgjuar.Ky djali ishte I papune,sado te kete ndihmuar babane dhe te jete lodhur,kur punon per vete nuk lodhesh kurre dhe nuk je kurre ne ate lloj presioni sa te duash kafe ne mes te nates dhe vec kesaj kur e di qe eshte shteterrethim,perse nuk e pi ate kafe ne shtepi,aq me teper si I papune nuk e ke luksin e frekuentimit te lokaleve?!Sa per policin ,me vjen keq qe nuk eshte permbajtur.Personi edhe pse I armatosur,po largohej me vrap,nuk duhej qelluar nga mbrapa,pasi nuk po bente rezistence ne ate moment.E shumta qe polici mund te bente ishte te qellonte ne ajer,duke e paralajmeruar dhe te therriste per ndihme patrrullen me te afert.Gjithashtu nje ligj duhet miratuar qe te ndershkoje rastet si ky servisi I makinave qe kamerat I fikin,nuk I vene ne pune,ose si kane fare.

Përgjigju

> **Free:** 09/12/2020 13:21
>
> Po ku jeton ti me zogu ku personat me precedente kontrollohen sa her dalin nga shtepia? Kamerat ne shqiperi nuk punojne sa here qe shteti shkel ligjin.

Bollino figlio di putana sporca: 08/12/2020 20:21

Policia ndryshon provat ne vendngjarje dhe bollino questo figlio di putana ben zedhensin e policise o shkerdhate gazetar qe ke ardhe nga p **i sateme ketu , se pak shkerdhata si ty kemi ne ketu.

Përgjigju

goni: 08/12/2020 19:17

po sikur skishte arme pa mire!!!!! keshtu qe nderro titull se si ka drejtuar armen hic dhe verifikoi lajmet o Karlo se na hiqesh gazetar i vjeter. Ah se harrova thuaji dhe gruas te beje njevartikull ku godeg veprimin e policise.....uuu lere se harrova ajo moralistja nuk ndiheg ne kesi rastesh ...te fala

Përgjigju

Arber: 08/12/2020 18:55

Kurr mos drejto armen ndaj efektit policor , do gjesh vdekjen para syve! pastaj politika mos te nderhyj ne punet e krimit qe i riu tentoj te vras policin ne detyre!!

Përgjigju

> **fierak:** 08/12/2020 19:58
>
> a u shofsh o cun ca ke qe ke kte mendje moterqir

ymeri: 08/12/2020 17:44

KETA kontigjentet e krimit e kane per ves te mos i binden policise,,,e te bejne si te forte,,,por gjejne nje hundelesh dhe shkojne per lesh..pse del ne rruge ne oren 12 te nates pa asnje arsye dhe i armatosur...//// ne amerike per te njejtin veprim vritesh ne vend dhe polici gradohet....///

Përgjigju

alfons: 08/12/2020 17:04

e arrestut policin o mjerane po punoni vete tani se nuk ka polic qe don te punoje me ju e dekurajuat policine

Përgjigju

AltinTop: 08/12/2020 16:37

Vritet polici i FNSH nuk hy kush ne burg...vritet nga polici nje me arme ne dore...hy ne burg Polici...

Përgjigju

JamKushJam: 08/12/2020 21:33

Bukur e ke thene !!!!!!

Trump: 08/12/2020 16:16

O polic, ta puthsha ate doren o vlla! Hero je per mu!

Përgjigju

Adi: 08/12/2020 16:46

Edhe per mu hero je se qerove nje hale gjith lapraka e dinte sa alabak ishte

Mirditor: 08/12/2020 15:58

Sa shqiptari vritet nga policia në itali ni zot e din

Përgjigju

Eri: 08/12/2020 15:54

Un e km provu vete thiken nkembe per i portofol se nuk po ja jepja dhe shikoja ku osh policia prdj kte cunin se njoh as ate policin per mendimin tim kto qe kan arme dhe thika brez jan pak te cmendur tgjith se i mencuri nuk te kerceno as me thik as me arme ne kete histori ishalla zbardhet e verteta

Përgjigju

Ema: 08/12/2020 15:39

Kur vret polocin ska ndodh gje e vrau per shkak detyre e nzerrin me kartel e pas tre mujesh e gjen jasht prap nga gjykatat tona te korruptuara . Kur te vret policia je i pa fajshem kishte dal me pi kafe ne dy te nates apo me bo ndonje pisllik e pastaj kerkojm qetesi nga policia e shteti e fain e ka edvini e lleshi hajde gjeje me ne o popull ku kemi arritur.

Përgjigju

JamKushJam: 08/12/2020 21:34

E vertet!!!

Vk komplet: 08/12/2020 15:25

Ne jena popull interesant. Po e zejme qe ky tipi ka pas arme dhe i ka hy nshpi nai robi me e grabit. Sa tipa si ky ka qe vjedhin apo grabisin??!! Dhe pastaj njerzit dalin e ankohen ku o policia, pse ska patrulla anej knej. Mire me ja ka bo se ropqim ishte ky qe vdiq, e njef gjithe lapraka ca halabaku ka qene, po kur vdes robi tgjithe e bojne burr tmire.

Përgjigju

JamKushJam: 08/12/2020 21:34

Fjale me vend!!!

Qytetari: 08/12/2020 15:13

Kjo eshte policia qe deshem. Del nje kriminel e vret cunin e ri kot. Turp ti vije. Me e pakta qe mund te beje sot, ministri Lleshaj te jape doreheqjen.

Përgjigju

Free: 08/12/2020 16:07

O luli qe ke cu nga gjumi bre

Mirditor: 08/12/2020 15:54

Ti po ban propagande politik me ngjarjen

Çudia e rradhës: 08/12/2020 14:54

Kjo ngjan si vrasje nga polici, duhet të hetohet ! Gjithsesi kjo ngjarje tregon se pas kesaj qitje perfekte në kokë, do këtë edhe një qitje pas 2/3 viteve. Dyshoj ketij polici ti dërgohet një formular nga SPAK se nuk duket shumë i kulluar! Mos harroni se nuk është aspak e veshtire me vra, keshtu vriste edhe tjetri para disa vitesh pra lum populli për politikën dhe shtetin që ka, para disa ditësh u vra një polic sot polici vret neser kushedi çfarë ndodh del ndonje ministër me bazuka qytetit, as hapje negociatash asgje nuk meritojmë vetëm një hapje te depove te armëve që ti kemi për të vrarë njeri tjetrin ! Kete pune e kemi qarëe vite ! Për personat pas ores 01:00 eshte masa e gjobês jo plumb kokës , kjo as në Kine nuk ndodh, e kishte gjet polici dhe ka kish vendos gjoben (e cila do të falej në 2021) kurse kjo që ka berë polici eshte gjobe e pakthyeshme pra polici eshte një zot që vendos për jetën tone ! Ngushëllime familjes !
